



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 12 prot.

Kamëz, më 10.02 2021

V E N D I M

Nr. 11 Datë 10.02.2021

MBI

**“TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË QË
NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **10.02.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.12 Datë 05.02.2021**, në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit nr.65 datë 25.06.2020, të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e Komisionit të Strehimit”, Vendimit nr.152 datë 18.12.2020 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë për Bashkinë Kamëz për familjet që nuk mund të përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë”, Vendimit nr 160 dt.23.12.2020 për “Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2021,2022,2023”,shkresës me nr.prot.773 dt.15.01.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe bazuar në vendimin e marrë nga Komisioni i Strehimit me nr.923 dt.01.02.2021, **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I:

1. Të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë për individët/ familjet sipas listës bashkëlidhur.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë 1 (një vjeçare),janar 2021 deri në dhjetor 2021.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika “1”, në shumën prej **11,773,264 (njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tremijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë** në muaj, do të përballohen me bashkëfinancim (60%-40%) në masën prej **7,063,958**

(shtatëmilion e gjashtëdhjetë e tremijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë nga MFE, dhe me vlerë **4,709,305** (katërmilion e shtatëqind e nëntë mijë e treqind e pesë)lekë nga buxheti i Bashkisë Kamëz sipas Prog 06180 Art 606 .

4. Bashkëngjitur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese.
5. Të ngarkojë Dr/e Finances dhe Kontabilitetit,Dr/e E.Civile dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

